



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1321 prot.

Vlorë, më 25.09 2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____, Datë _____ 2023

“PËR EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORE”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1 , pika 1.1/b pika 2, 9, neni 54 pika II, neni 55 pika 2 si dhe në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës _____,

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës “Sherif Hekuran Sinaj” e cila është pjesë e segmentit rrugor në Lagjen “Isa Boletini” Rruga “Mehmet Cico Petoshati” sipas planvendosjes bashkelidhur .
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Konceptoi: *S.Kalemi*

Miratoi: *D.Demiraj*

Nr.Kopjesh: 6 (gjashtë)

Nr.Fletësh: 1(një)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 11321 prot.

Vlorë, më 25.9 2023

RELACION
MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR EMËRTIMIN E RRUGËS SHERIF HEKURAN
SINAJ”

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi “Për emërtimin e Rrugës Sherif Hekuran Sinaj”, e cila është pjesë e segmentit rrugor ne Lagjen “Isa Boletini” Rruga “Mehmet Cico Petoshati”, sipas planvendosjes bashkëlidhur, që ju paraqesim për miratim bazohet në propozimin e Kryesisë së Organizatës së Deshmorëve me shkresën datë 20.09.2023 protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr.11059 Prot, datë 20.09.2023 si edhe administratës së Bashkisë Vlorë.

Sipas propozimit të paraqitur nga propozuesit, Z.Sherif Hekuran Sinaj ka lindur në fshatin Mallëkëq të rrethit Vlorë në vitin 1905 ne një familje me tradita patriotike. Ishte me i madhi i fëmijëve, kish trashëguar anët më pozitive të prindërve. Natyra i kish falur zgjuarsinë, bujarinë bamirësinë, bukurinë e rrallë trupore dhe shpirtërore, futej në rrethin e intelektualëve të kohës, sepse kish kryer studimet fillore dhe studimet e mesme në ish-shkollën tregtare të qytetit Vlorë. Z.Sherif Hekuran Sinaj ishte një patriot i përkushtuar, luftëtar me armë në dorë në luftën patriotike të Vlorës në vitin 1920 që përfundoi me fitoren e patriotëve vlonjatë e të Labërisë, përkrahës i revolucionit Demokratiko-Borgjez të qershorit 1924 që u udhëhoq nga patrioti i madh shqiptar me Fan Stilian Noli si edhe si gjithë populli ishte edhe kundra regjimit të urreyer te mbretit Ahmet Zog Matjani.

Gjithashtu ka spikatur në marrëdhëniet e shkelqyera me familjen si dhe komunitetin duke manifestuar parimet e një luftëtari të devotshëm, të përkushtuar, të qytetëruar që ngriti lart Atdheun, nderin dhe detyrën konkretisht si më poshtë:

Okupimin e Shqipërisë nga Italia fashiste ne 7 prill 1939 e luftoi me të gjitha format që nga agjitacioni i propogandës deri te lufta me armë në dorë.

Së bashku me luftëtarë të tjere të fshatit Mallëkëq dhe krahinës së Sevasterit organizuan dhe bashkëluftuan kundra forcave okupuese fashiste italiane dhe naziste gjermane si ne Bestrovë, Qafa e Ullinjve , në Mavrovë, në Drashovicë, Velçë e deri në rrethinat për çlirimin e Vlorës. Për një kohë të shkurtër Sherifi ka qënë efektiv i batalionit “Perlat Rexhepi”.

Patriotizmin perkushtues e ne formë të organizuar e zhvilloi pas kontaktit me udhëheqës e organizatorë vlonjatë të Luftës Antifashiste Nacional-Clirimtare te popullit shqiptar si: Hysni Kapo, Rrapo Dervishi, Ymer Veshi, Halim Ramohito etj në fillimin e viteve 1942.

Ne datën 20 tetor të vitit 1942 duke spikatur per aftesite dhe perkushtimin ne veprimtaritë patriotike u emerua Sekretar i Keshillit Antifashist Nacional-Clirimtare te fshatit Mallëkëq, detyrë të cilën e realizoi me sukses deri ne flijimin e jetës ne 15 Tetor 1944 duke shkuar dere me derë per të shpërndarë komunikata e trakte që i dërgonte qendra organizuese dhe udhëheqëse e luftës.

Sherif Sinaj u spikat gjithashtu ne aftesite organizative dhe argumentuese duke larguar krerët e Ballit Kombetar te perplaseshin me partizanët.



Për informacion më të detajuar rreth figurës së Z.Sherif Hekuran Sinaj, bashkëlidhur këtij relacioni janë shkresat e depozituara nga propozuesit, nëpërmjet të cilave shprehet pa diskutim kontributi i shquar i tij ne luftën Antifashiste Nacional-Clirimtare. Për merita patriotike dhe gjestin human deri ne humbjen e jetës shteti shqiptar e ka deklaruar Dëshmor të Atdheut duke i ndërtuar edhe varrin në varrezat e dëshmorëve të qytetit të Vlorës.

Referuar sa parashtruar më lartë, vlerësojmë se është në nderin e Këshillit të Bashkisë të miratojë këtë projekt- vendim për një personalitet që i jep nder jo vetëm qytetit të Vlorës por edhe më gjerë .

KRYETARI

Ermal Dredha





BASHKIA VLORE

DREJTORIA E URBANISTIKËS

GRUPI I PROJEKTIMIT:
Drejtor Zambak Selmani

BASHKIA VLORE 2023

SEGMENTI RRUGOR I PROPOZUAR NDODHET NE LAGJEN "ISA BOLETINI" PRANE SHKOLLES "MUÇO DELO", VLORE. AKTUALISHT KJO RRUGE MBAN EMRIN "MEHMET ÇIÇO PETOSHATI". PROPOZOHET QE NJE SEGMENT I KESAJ RRUGE, SIPAS PLANIT TE VENDOSJES, TE MARRE EMRIN "SHERIF HEKURAN SINAJ"

— — — — — SEGMENTI RRUGOR I PROPOZUAR